

## **Tema: Lufta dhe ndjekja e dhunës me bazë gjinore**

### **“Për çfarë luftojmë?”**

**Fjalët kyçe:** përkufizimi i dhunës me bazë gjinore; format e dhunës me bazë gjinore; parandalimi dhe shkaqet bazike për DhBGj-në; mbrojtja dhe ndjekja penale e krimeve; zbatimimi i ligjeve dhe politikave; kushtëzimi i BE-së për sigurinë njerëzore dhe sundimin e ligjit.

### **Zonat e përqendrimit**

Dhuna me bazë gjinore, çfarë nënkuptojmë me DhBGj-në?

Në format e përhapura të DhBGj-së në Kosovë bëjnë pjesë, por nuk kufizohen vetëm në dhunën kundër civilëve gjatë një konflikti, dhunën seksuale, diskriminimin gjinor, dhunën në familje, trafikimin e qenieve njerëzore për qëllime të shfrytëzimit seksual, ngacmimin seksual, dhe dhunën e cila ndërlidhet me sigurinë njerëzore, në terma më të gjerë.

DhBGj-ja është një çështje e sigurisë njerëzore dhe sundimit të ligjit, meqenëse gratë dhe vajzat pozicionohen ndryshe në shoqëri, me nevojë dhe interesa të ndryshme. Në mënyrë të veçantë, pozita e tyre kulturore, shoqërore dhe ekonomike e pengon nivelin e gëzimit të të drejtave dhe qasjes në drejtësi. DhBGj-ja është gjithashtu edhe çështje e shëndetit publik, meqenëse dhuna kundër grave shtatzëna shpeshherë ushtrohet nga ushtruesit e dhunës në familje, duke ndikuar në nivelin e angazhimit të grave në sferën publike dhe punësim, duke ulur në këtë mënyrë përfitimet ekonomike për shtetin (jepni shembuj).

**Fakt:** Gratë vazhdojnë të mbahen në sferën private dhe të mbeten në rrezik potencial të dhunës në familje dhe të varura ekonomikisht nga meshkujt. 18 % e grave janë të punësuar, përkundrajt 53 % të burrave në popullsinë aktive ekonomike të Kosovës (të dhëna të Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Bankës Botërore, 2013).

### **Analizë e shkurtër e situatës:**

- Kosova ka bërë një rrugë të gjatë në trajtimin e nevojave të viktimave të dhunës me bazë gjinore, duke miratuar ligje, politika dhe mekanizma. Megjithatë ajo mbetet prapa në zbatim, për shkaqe të ndryshme.
- Në mesing e disa prej shkaqeve të renditura, të cilat ndikojnë në zbatim janë: mungesa e mirëkuptimit kulturor për nevojën e trajtimit të dhunës kundër grave dhe vajzave, duke përfshirë elitën politike; vullneti politik shpeshherë është reflektuar në miratimin e shumë ligjeve dhe politikave, si listë kontrolli, duke mos ofruar kështu burime të mjaftueshme njerëzore dhe buxhetore; mungesa e përgjithshme e sundimit të ligjit në Kosovë, d.m.th. grumbullimi i rasteve në gjykata dhe korrupsioni, si dhe zbatimimi i kufizuar apo selektiv i ligjeve nga ana e institucioneve dhe gjykatave në veçanti.
- Kosova vazhdon të përballet me sfida madhore në lidhje me zbatimin e ligjeve dhe, në mënyrë të veçantë, të çështjeve të sundimit të ligjit, të cilat janë përjetësuar më tej nga korrupsioni, zbatimimi i dobët i vendimeve të gjykatës dhe ekzekutimi i kontratave (numri i lëndëve të vjetra në gjykata vlerësohet të jetë mbi 235,000).

## **Sfidat:**

### **Fakte:**

Vërejtje e përgjithshme: Të gjitha institucionet me mandat ligjor për ndihmimin e viktimave të DhBGj-së nuk ofrojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë për krimet e kryera, shërbimet e ofruara dhe numrin e viktimave të DhBGj-së të cilat janë ndihmuar, meqenëse kjo kategori nuk është e caktuar në mënyrë specifike në ligjet e Kosovës. Megjithëse ekzistojnë pak të dhëna, ato i ngjasojnë më shumë atyre të tipit *ad hoc* dhe nuk është zhvilluar asnjë mbledhje sistematike. Në përgjithësi, ka sisteme të papërshtatshme për mbledhjen e të dhënave, të cilat medoemos duhet të korrigjohen në mënyrë të menjëhershme. Zyrtarët për Barazinë Gjinore në nivele komunale dhe ministrore, kanë qasje të kufizuar në të dhëna dhe ndikim po të atillë në kuadër të ministrive/komunave të tyre. Monitorimi i dhunës dhe mbledhja e të dhënave do të mund ta përmirësonin analizën dhe nevojat buxhetore për institucionet e Kosovës.

- Analiza e të dhënave nga RrGGK në vitin 2012 për Shpenzimet Shtetërore për Dhunën në Familje ka treguar se në vitin 2011 vetëm **0.13%** e shpenzimeve të Kosovës kanë shkuar për shërbimet e financuara nga shteti. Me pak fjalë, shërbimet të cilat lidhen me dhunën në familje kushtojnë € 1,76 për banor dhe € 1.11 për person në taksa çdo vit.
- Shërbimet qeveritare të Kosovës, të cilat lidhen me trajtimin e dhunës në familje, kushtojnë të paktën €3,060,116, prej të cilave raporti i mbështetjes qeveritare është në masën 60 %, ndërsa ajo e donatorëve 40 %.
- Qeveria dhe donatorët kanë alokuar në mënyrë të konsiderueshme më shumë burime për mbrojtjen (€2,088,581) sesa parandalimin (€526,264), apo rehabilitimin dhe ri-integrimin (€399,585);
- Numri i grave dhe burrave të cilët vuajnë nga DhF-ja (intervistat e vitit 2008 të RrGGK-së): 46.4 % gra dhe 39.6 % burra. Në total, 43 % e më shumë sesa 1000 të intervistuarve kanë pësuar nga DhF-ja.
- Numri dhe përqindja e viktimave të DhF-së, të raportuar në polici, janë 1089 raste, prej të cilave 80 % janë gra dhe 20 % burra.
- Viktimat e trafikimit, të identifikuar për vitin 2013, janë 52.
- Format e tjera të DhBGj-së mbeten të pa raportuara, si: përdhunimi i grave, vajzave dhe burrave gjatë luftës së viteve 1998-1999; përdhunimi i grave dhe vajzave në përgjithësi; dhuna kundër personave LGBT, etj.

### **Angazhimet e qeverisë së Kosovës:**

- Plani i Veprimit për Partneritet Evropian në vitin 2012 e ka prekur në mënyrë të kufizuar mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të grave, duke ndarë vetëm 100,000 Euro për vitin 2012 për zbatimin e të drejtave të grave, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të tij.
- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore ka përfunduar në vitin 2013. Do të duhet të hartohet një draft i ri, duke marrë parasysh edhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i planit të kaluar. Raportimi i rregullt në Kuvendin e Kosovës nga ana e qeverisë do të duhet të jetë prioritet për Programin e ardhshëm. Kjo nuk ka ndodhur asnjëherë në Programin e kaluar, ndonëse parashikohej nga Ligji për Barazi Gjinore i Kosovës.
- Kohët e fundit, Rezoluta 1325 e KSOKB-së për Planin e Veprimit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, është miratuar nga qeveria e Kosovës. Nga qeveria është zotuar vetëm gjysma e nevojave buxhetore për zbatimin e PV-së

### **Trajtimi i DhBGj-së në dokumentet e BE-së:**

- Udhërrëfytyesi i Liberalizimit të Vizave për Kosovës kërkon që institucionet e Kosovës ta miratojnë dhe zbatojnë legjislacionin për të parandaluar, hetuar dhe ndjekur penalisht trafikimin e qenieve njerëzore; “të përmirësojë parandalimin, zbulimin dhe hetimin e krimeve të rënda kufitare/ndër-kufitare, veçanërisht trafikimin e qenieve njerëzore”; dhe të ngrenë kapacitetet e autoriteteve përkatëse për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e trafikimit.
- Të drejtat dhe grave dhe barazia gjinore përmendet në një nen të veçantë të Raportit të Progresit për Kosovën për vitin 2013, duke kërkuar po ashtu që institucionet të hartojnë një Program të ri për Barazinë Gjinore. Çështja e barazisë gjinore zë një vend dytësor në dokumentet përkatëse të BE-së, në vend që të ketë një vend parësor.
- Format e tjera të dhunës me bazë gjinore janë përmendur në mënyrë sporadike. Institucionet e Kosovës do të duhet të kushtëzoheshin përmes neneve të Raportit të Progresit, ose duke përfshirë një kapitull të veçantë për barazinë gjinore në Kosovë, duke rritur presionin mbi to për zbatimin e ligjeve.

### **Rruga përpara:**

Ekzistojnë shumë menyra për trajtimin e DhBGj-së në Kosovë. Kosova do të duhet të përqendrohet në rezultatet e menjëhershme dhe ato afat-mesme.

### **Parandalimi:**

- Në dispozicion të grave dhe fëmijëve të cilët kanë vuajtur nga dhuna, nuk ekzistojnë shërbime të ri-integrimit afatgjatë, kryesisht për shkak të fondeve dhe infrastrukturës së papërshtatshme. Programi për ri-integrim do të duhet të hartohet nga ana e të gjitha palëve të interesuara, duke përfshirë zhvendosjen, subvencionimin e strehimit, asistencën në gjetjen e punësimit, dhe shërbimet e vazhdueshme të këshillimit. Gjithashtu, edhe roli i autoriteteve komunale do të duhet të realizohet në pajtim me mandatin e tyre ligjor për mirëqenien sociale.
- Meqenëse Strategjia Kundër Trafikimit do të skadoj, kanë filluar përpjekje për të hartuar një Strategji të re për periudhën 2014-2018. Një pengesë kyçe në zbatimin e Strategjisë ekzistuese ka qenë buxheti i pamjaftueshëm, i cili është alokuar brenda kuadrit të planit të saj të veprimit. Në veçanti rehabilitimi dhe ri-integrimi kanë pasur financim tejet të ulët.

### **Mbrojtja:**

- Nën udhëheqjen e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, organet e mëposhtme do të duhet të zhvillojnë një sistem të raportimit për krimet dhe karakteristikat e DhBGj-së. Sistemi i raportimit do të përfshinte mbledhjen dhe përpunimin e rregullt të të dhënave nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, ndihmuar nga Departamenti për Ndhimë Viktimave, Ministria e Drejtësisë, Departamenti i Mirëqenies Sociale i MPMS-së, Qendrat për Mirëqenie Sociale, Qendrat Rajonale të Punësimit, etj., me qëllim që reagimet ndaj viktimave të DhBGj-së të analizohen dhe trajtohen siç duhet.
- Themelimi i domosdoshëm i shërbimeve institucionale për trajtimin e kryerësve të dhunës, veçanërisht burrave.
- Do të duhet të parashikohet dhe zbatohet fondi i kompensimit për viktimat e DhBGj-së. Kjo do ta përmirësonte të drejtën për t’iu qasur drejtësisë dhe mjeteve juridike, sikundër përcaktohet nga Gjykata e BE-së për DNj-të dhe do të garantonte zbatueshmërinë sipas kushtetutës së Kosovës. Kompensimi për krimet e vuajtura për viktimat e përdhunimit,

trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual dhe dhunës në familje do ta përmirësonin pavarësinë ekonomike të këtyre viktimave dhe do t'i fuqizonte ato në mënyrë të plotë për t'u integruar në shoqëri. Viktimat e Kosovës kanë 15 vjet tashmë që presin që institucionet e Kosovës t'iu ofrojnë kompensim për krimet që i kanë vuajtur.

### **Ndjekja penale:**

- Prioritizimi i hetimit të krimeve të DhBGj-së, duke përfshirë dënimin e duhur të kryerësve të trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës në familje. Në veçanti, rastet përsëritëse nuk mund të vazhdojnë vetëm të gjobiten, por përsëritja do të duhet të dënohet në mënyrë të duhur sikundër parashikohet me ligj. Në studimin e vitit 2010, RrGGK ka gjetur se 80 % e rasteve të viktimave të DhF-së kanë vuajtur nga dhuna në të kaluarën nga i njëjti partner, ndërkohë që drejtësia nuk ka vepruar edhe pse përcaktohet me ligj.
- Regjistrimi i shënimeve për dënimin e rasteve të trafikimit apo dhunës në familje do të duhet të kryhet sikundër parashikohet me ligj, ndërkohë që dënimet nga gjykatave do të duhet të monitorohen në mënyrë të rregullt.

### **Koordinimi:**

- Qeveria duhet të alokojë patjetër mbështetje të mjaftueshme financiare për të zbatuar ligjet, politikat dhe strategjitë e saj të shumta.
- Në këtë aspekt, gjithashtu edhe procesi i integritimit në BE do të duhet të shihet si një mundësi për t'i kushtëzuar institucionet e Kosovës që të mbrojnë në mënyrë të plotë gëzimin e të drejtës së pronës, projektet e punësimit të cilat do të destinoheshin për gratë dhe të drejtat e tjera, si të drejtat themelore të garantuara nga ligjet e Kosovës. Kjo do të çonte në rritje të përgjithshme ekonomike duke përmirësuar kapacitetin e grave për të themeluar bizneset e tyre vetjake, sapo të kenë nën pronësi pasuri, dhe duke forcuar rolin dhe pozitën e tyre ekonomike dhe shoqërore në kuadrin e familjes.
- Me qëllim që të nisen reformat e brendshme, kërkesat e BE-së do të duhet të jenë të orientuara në tregues dhe të jenë të matshme, duke kërkuar raporte për numrin e rasteve të raportuara, hetuara, dënuara dhe kompensuara në pajtim me ligjet në fuqi.
- Edhe monitorimi nga OJQ-të do të duhet të mbështetet në vëzhgimin e nivelit të zbatimit në raport me çështjet e sigurisë dhe sundimin e ligjit, për viktimat e DhBGj-së. Analizat e rregullta të ndikimit, në pajtim me *EU Acquis*, do të duhet të kryheshin në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë dhe OJQ-të.

### **Përgatitur dhe prezantuar nga:**

**Ariana Qosaj – Mustafa**

Kryesuese e Bordit të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK)